L I G J
Nr.9510, datë 10.4.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ARTIGIANCASSA S.P.A. PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT "PERIFERITË URBANE TË TIRANËS – KOMPONENTI INFRASTRUKTUROR""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe ARTIGIANCASSA S.P.A. për financimin e programit "Periferitë urbane të Tiranës – komponenti infrastrukturor"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4844, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE FINANCIARE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE ARTIGIANCASSA S.P.A

EURO 3 000 000, 00

PROGRAMI PËR PERIFERITË URBANE TË TIRANËS
KOMPONENTI INFRASTRUKTUROR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (në vijim i quajtur si "Huamarrësi"), i përfaqësuar nga Ministria e Financave nga njëra anë, dhe Artigiancassa S.p.A., e listuar në regjistrin e bankave me një kapital 35 000 000, 00 me zyrë të regjistruar në Romë, Via Crescenzo del Monte 25, me regjistër të kompanive, kodi i taksës no.01158450583, TVSH no.00968081000 (në vijim e quajtur "Artigiancassa"), si administratori i Fondit Qarkullues për Bashkëpunim Zhvillimi në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave të Italisë, i krijuar në përputhje me nenin 26 të ligjit italian nr.227 të 24 majit 1977 dhe më tej duke iu referuar nenit 6 të ligjit italian nr.49 të 26 shkurtit 1987, përfaqësuar nga z.Carlo Larcinese, nga ana tjetër. (Artigiancassa dhe Huamarrësi së bashku do të quhen në vijim si "Palët"),

kanë vendosur këtë Marrëveshje financiare

Neni 1
Përkufizime

Në këtë Marrëveshje dhe në anekset përkatëse, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet si vijojnë:

"Njohje e Borxhit", do të thotë deklarimi që i referohet nenit 10, sipas të cilit Huamarrësi merr përsipër të shlyejë në favor të Artigiancassa kapitalin plus interesin që i detyrohet në zbatim të kësaj Marrëveshjeje;

"Banka Agjente" do të thotë institucioni financiar (Artigiancassa), e cila do të përfshihet në këto aktivitete:

- kontroll të dokumentacionit kontraktues;
- veprimet disbursuese;
- veprime të pagesave.

"Marrëveshje" do të thotë Marrëveshja financiare aktuale, preambola dhe anekset përkatëse që formojnë një pjesë integrale;

"Banka shqiptare" do të thotë banka e caktuar nga Huamarrësi si banka korresponduese e Artigiancassa që vepron si Bankë Agjente për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;

"Dokumentacioni kontraktues" do të thotë dokumentacioni që i referohet kontratës/kontratave të furnizimit (p.sh.faturat, llogaritë e ngarkesave, listat e paketimeve, punimet në proces;

"Periudha falas" do të thotë periudha që zgjat 204 muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë;

"Autoritetet Kompetente Italiane" do të thotë Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë dhe/ose ndonjë njësi kompetente tjetër e Republikës Italiane, e emërur për qëllime të kësaj Marrëveshjeje;

"MAE/DGCS" do të thotë Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Italisë-Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim dhe Zhvillim;

"Program" do të thotë projekti që lidhet me "programin për periferitë urbane të Tiranës-Komponenti infrastrukturor" i miratuar në bazë të Marrëveshjes Qeveritare nga Qeveria e Republikës së Italisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, e financuar krejtësisht në kuptimin e kredisë së butë;

"Njësia e zbatimit të projektit (NJZP)" do të thotë njësia teknike e ngritur në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit për zbatimin e programit;

"Hua e Butë" do të thotë financimi që Artigiancassa, në bazë të autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe sipas propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, do të akordojë në termat dhe kushtet e ofruara nga neni 1 dhe neni 3 i kësaj Marrëveshjeje;

"Kontrata/kontratat e furnizimeve" do të thotë kontrata/kontratat tregtare që lidhen me furnizimin e mallrave dhe/ose të shërbimeve nga eksportuesit italianë tek importuesit shqiptarë, që kanë të bëjnë me realizimin e programit.

Neni 2
Hyrje

2.1 Në kuptim të Marrëveshjes së njohur si "Marrëveshje Qeveritare" (në vijim e referuar si "Marrëveshja Qeveritare") e nënshkruar më 29 janar 2004, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Repulikës së Italisë, kjo e fundit është angazhuar të financojë programin që lidhjet me "Periferitë urbane të Tiranës-Komponenti infrastrukturor) me anë të një huaje të butë me një maksimum prej 3 000 000,00 (tre milionë) euro.

2.2 Në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje palët kanë si qëllim: (i) të zbatojnë financimet që lidhen me huanë e butë të përcaktuar në Marrëveshjen Qeveritare dhe (ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me Marrëveshjen Qeveritare.

2.3 Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e Qeverisë së Republikës të Italisë, në bazë të propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, me dekretin nr.79144, datë 18 korrik 2005 ka autorizuar Artigiancassa t'i akordojë Huamarrësit një hua të butë në termat dhe kushtet e përcaktuara në nenet 3 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje (në vijim e referuar si "Hua e Butë") për qëllime të financimit të programit.

2.4 Artigiancassa për qëllime të kësaj Marrëveshjeje do të veprojë si Bankë Agjente dhe banka shqiptare do të jetë Raiffeisen Bank në Shqipëri

Neni 3
Hua e Butë

3.1 Artigiancassa i akordon Huamarrësit dhe Huamarrësi nga kjo pranon Huanë e Butë me kushtet e mëposhtme:

- Shuma: maksimum deri në 3 000 000, 00 (tre milionë) euro;
- Kohëzgjatja: 38 vjet;
- Shlyerja: 42 vjet (dyzet e dy) këste të principalit të barabarta gjysmëvjetore të njëpasnjëshme, i pari i të cilëve bëhet i pagueshën 210 (dyqind e dhjetë) muaj prej datës së disbursimit të parë;
- Norma e interesit nominale 0.10% në vit (zero pikë dhjetë për qind) e pagueshme në fund të çdo periudhe të 6 (gjashtë) muajve prej datës së çdo tërheqje;
- Qëllimi i kredisë "Programi për periferitë urbane të Tiranës – Komponentë infrastrukturorë.

3.2 Huaja e Butë do të përdoret për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve me origjinë italiane. Një shumë maksimale prej 40 (dyzet)% e shumës referuar Huasë së Butë mund të përdoret për të mbuluar kostot lokale dhe të importimit të mallrave dhe shërbimeve me origjinë prej vendeve në zhvillim.

Secila dhe çdo kontratë, që lidhet me kostot lokale dhe importimin e mallrave, që kanë origjinën nga vendet në zhvillim do të negociohet vetëm përmes dhe të nënshkruhet nga një kontraktor/eksportues kryesor italian. Kontratat e furnizimit do të jenë në euro.

3.3 Huaja e Butë nuk mund të përdoret për të financuar:

Taksat lokale, taksat doganore dhe TVSH-në.

3.4 Kontratat e furnizimit që lidhen me programin sipas nenit 2.1 do të prokurohen përmes ofertave publike të rezervuara për kompanitë italiane mbi bazën e procedurave të ofruara në: "Manualin e procedurave" (të përshtatura nga Komisioni Europian në 23 dhjetor 2002) lidhur me shërbimet, furnizimet dhe kontratat e punimeve të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komisionit Europian në kontekstin e bashkëpunimit me vendet e treta".

3.5 Huaja e Butë do të bëhet e disponueshme në përputhje me termat dhe kushtet e vendosura në këtë Marrëveshje.

Neni 4
Bërja efektive e Marrëveshjes financiare

4.1 Kjo Marrëveshje do të bëhet efektive pasi Artigiancassa të ketë marrë prej Huamarrësit dokumentet e mëposhtme përmes Ambasadës Italiane-Ambasada/Zyra e Bashkëpunimit:

i) Një deklaratë nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë duke pasqyruar autoritetin e Huamarrësit për të nënshkruar në emër të Qeverisë shqiptare këtë Marrëveshje nga një person i autorizuar sipas rregullit në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe vepruese në Shqipëri dhe të marrë përsipër detyrimet e lindura nga kjo Marrëveshje.

ii) Emërimin me shkrim nga një autoritet kompetent i Huamarrësit i personit/personave të autorizuar në mënyrë të rregullt për ta nënshkruar këtë Marrëveshje (të vërtetuar nga Ambasada Italiane në Tiranë, Ambasada/Zyra e Bashkëpunimit), kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit në formën e aneksit A dhe njohjen e borxhit në formën e aneksit C referuar nenit 10 më poshtë. Një përcaktim i tillë duhet të specifikojë emrin dhe zyrën e këtij personi/personave dhe të përmbajë "specimentin" azhurnuar të firmave të tyre. Ndonjë ndryshim i kësaj (nëse ka ndonjë) duhet të transmetohet në kohë nga Huamarrësi tek Artigiancassa.

4.2 Artigiancassa, pasi të ketë marrë dokumentet e lartpërmendura dhe të jetë plotësisht e kënaqur me to, do të njoftojë Huamarrësin dhe bankën shqiptare me anë të letrës ose faksit, i cili pastaj duhet të pasohet nga një letër e konfirmuar, datën në të cilën kjo Marrëveshje do të bëhet efektive.

Neni 5
Termat për disbursimet e Huasë së Butë

5.1 Periudha e disbursimit e Huasë së Butë do të jetë 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga data e disbursimit të parë. Një periudhë e tillë mund të zgjatet nga Artigiancassa. Pavarësisht sa më sipër Artigiancassa nuk mund të zgjasë periudhën e disbursimit, në rast se Huamarrësi ose Autoriteti Kompetent Italian nuk janë dakord për një shtyrje të tillë dhe të kenë njoftuar kështu me shkrim Artigiancassa së paku 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para skadimit të datës së periudhës së disbursimit.

5.2 Në rast se periudha e disbursimit ka skaduar dhe nuk mund të zgjatet, Artigiancassa pasi të jetë konsultuar me Autoritetet Kompetente Italiane do të informojë Huamarrësin për anulimin e angazhimit të Artigiancassa-s në lidhje me fondet e papërdorura.

Neni 6
Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e Huasë së Butë

6.1 Huaja e Butë mund të përdoret nga Huamarrësi, pasi të plotësojë kushtet e mëposhtme:

i) autorizimin e dhënë nga Autoriteti Kompetent Italian për të alokuar kontratën/kontratat e furnizimit të Huasë së Butë;

ii) rezultate të kënaqshme nga kontrolli i bërë nga Artigiancassa sipas nenit 6.2(i) më poshtë;

iii) marrjen nga Artigiancassa të kërkesës së financimit të kontratës së furnizimit të parashikuar nga neni 7.1 më poshtë.

6.2 Pas marrjes së autorizimit të përmendur në pikën 6.1 (i) më sipër, Artigiancassa do të kryejë menjëherë veprimet si më poshtë:

i) Të bëjë kontrollin mbi bazën e kërkesës parashikuar nga Autoriteti Kompetent Italian mbi eksportuesin italian dhe mbi individët/kompanitë italiane, nëse ka, të përfshirë me organizatat lokale dhe mbi kontratën/kontratat e furnizimit. Në lidhje me kontratën/kontratat e furnizimit, Artigiancassa do të verifikojë që ato janë në përputhje me termat dhe kushtet e Huasë së Butë dhe që ato janë mjaftueshmërisht të detajuara përsa i përket zërave të kostove/çmimeve në mënyrë që të lejojë kontrollet sipas nenit 8.3.

ii) Të njoftojë Huamarrësin dhe bankën shqiptare për marrjen e autorizimit sipas nenit 6.1 (i) më sipër dhe t'i kërkojë bankës shqiptare të nisë kërkesën e parashikuar sipas nenit 7.1.

6.3 Rezultatet e suksesshme të kontrollit të bërë nga Artigiancassa sipas nenit të mësipërm 6.2 (i), do të sjellë alokimin e kontratës/kontratave të furnizimit tek Huaja e Butë. Financimi i kontratës së furnizimit do të bëhet vetëm pas plotësimit të kushteve të vendosura sipas nenit 6.1 (iii).

6.4 Artigiancassa do të njoftojë Huamarrësin, bankën shqiptare, NJZP-në dhe eksportuesin italian për alokimin, si dhe gjithashtu për financimin e kontratës/kontratave të furnizimit.

Neni 7
Kërkesa për financimin e kontratës së furnizimit

7.1 Pas njoftimit të rezultatit të kënaqshëm të kontrollit sipas nenit 6.2 (i) banka shqiptare duhet t'i transmetojë Artigiancassa-s një kërkesë për financimin e kontratës së furnizimit të nevojshme për pagesat e parashikuara në çdo kontratë furnizimi. Me anë të një kërkese të tillë, e cila duhet të jetë në formën e aneksit A, Huamarrësi do të vërtetojë që kontrata/kontratat e furnizimit është/janë e/të pranueshme për t'u financuar dhe do të marrë përsipër t'i rimbursojë Artigiancassa-s shumën e disbursuar.

7.2 Kërkesa për financim e kontratës së furnizimit e bërë sipas nenit 7.1 do të merret në afatin e caktuar dhe asnjëherë më vonë se gjashtë muaj prej datës së njoftimit prej Artigiancassa-s, të parashikuar në bazë të nenit 6.4 më sipër, ose kushtit (nëse ka ndonjë) të shprehur në kontratën e furnizimit. Pas skadimit të periudhës së lartpërmendur Artigiancassa, pas konsultimit me Autoritetin Kompetent Italian, do të konsiderojë anulimin e mundshëm të kontratës/kontratave të furnizimit të alokuara tek Huaja e Butë.

Neni 8
Disbursimet

8.1 Kërkesa për financimin e çdo kontrate furnizimi e parashikuar sipas nenit 7 do të bëhet nga banka shqiptare në raport me çdo pagesë për t'u bërë në përputhje me kushtet e shprehura në kontratën e furnizimit, pas dorëzimit të dokumentacionit kontraktues.

8.2 Eksportuesi italian do të dorëzojë dokumentacionin kontraktues dhe do të kërkojë disbursimin e shumës përkatëse në përputhje me kontratën e furnizimit në formën e aneksit B. Një kopje origjinale e dokumentacionit kontraktues do t'i dërgohet në të njëjtën kohë nga Artigiancassa bankës shqiptare dhe NJZP-së.

8.3 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike prej datës së dërgimit nga Artigiancassa të dokumentacionit kontraktues të mësipërm, NJZP do të njoftojë me shkrim Artigiancassa-n dhe me një kopje bankën shqiptare për përputhjen e furnizimit të mallrave dhe/ose shërbimeve me dokumentacionin kontraktues përkatës.

8.4 Në vijim të marrjes së çdo kërkese për disbursim, Artigiancassa do të kontrollojë dokumentacionin kontraktues. Një kontroll i tillë do të përfshijë përputhshmërinë e dokumentacionit kontraktues me kontratën e furnizimit përkatës.

8.5 Pas çdo hetimi të suksesshëm të bërë sipas nenit 8.3 dhe kontrolli të suksesshëm të bërë sipas nenit 8.4, Artigiancassa do të disbursojë shumën përkatëse në llogari brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike prej datës së marrjes të çdo kërkese për disbursim dhe konfirmon me telex ose fax në bankën shqiptare dhe Ministrinë e Financave për shumën totale të disbursimit dhe datën në të cilën i është kredituar fondi eksportuesit/eksportuesve italianë.

8.6 Artigiancassa do t'i bëjë pagesat në favor të eksportuesit/eksportuesve italian/ë dhe do të marrë prej eksportuesit/eksportuesve italian/ë të tillë faturën e shkarkimit të bërë sipas aneksit D në dy origjinale, njëra prej të cilave do t'i dorëzohet bankës shqiptare.

8.7 Në vijim të çdo pagese në favor të eksportuesit/eksportuesve italianë, Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit dhe bankës shqiptare një pasqyrë të përditësuar të shlyerjeve, e cila të tregojë të gjitha shumat e disbursuara deri në dhe përfshirë disbursimin e fundit, duke treguar datat përkatëse të tyre në përputhje me nenin 9 më poshtë. Huamarrësi do të konfirmojë me shkrim pranimin e tij për pasqyrën e mësipërme të pagesave të përmendura më lart.

Neni 9

Shlyerja e Huasë së Butë dhe pagesa e interesit

9.1 Çdo shumë e disbursuar do të ripaguhet në përputhje me pasqyrën e shlyerjeve në 42 (dyzet e dy) këste të njëpasnjëshme të barabarta të ndara në çdo gjashtë muaj (më poshtë të quajtura si këste të principalit), i pari i të cilëve do të bëhet i pagueshëmn 210 (dyqind e dhjetë) muaj pas disbursimit të parë. Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit dhe bankës shqiptare pasqyrën e shlyerjeve në përputhje me nenin 8.7.

9.2 Për kështet e principalit të kredituara efektivisht, të papaguara, interesi i vonesës do të llogaritet me një normë vjetore prej 0.1% (zero pikë një për qind) e barabartë me 0.05% (zero pikë zero pesë për qind) për gjysmën e vitit, prej datës në të cilën fondet kanë qenë kredituar deri në datën e shlyerjes së këstit të fundit të principalit. Interesi do të llogaritet në numrin e ditëve aktualisht të kaluara mbi bazën e muajit tridhjetë ditësh dhe të një viti prej treqind e gjashtëdhjetë ditësh (30/360).

9.3 Gjatë periudhës së shlyerjes, interesi do të paguhet në të njëjtën datë të përcaktuar për këstin e principalit. Gjatë periudhës falas, interesi do të paguhet çdo 6 (gjashtë) muaj në datat korresponduese, në ditë dhe muajt, të datave të shlyerjes së këstit të principalit. Kësti i parë i interesit mund t'i referohet një periudhe prej më pak se gjashtë muajsh. Megjithatë, nëse kjo periudhë do të jetë më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, kësti i interesit korrespondues do të paguhet së bashku me këstin e interesit pasues. Kësti i parë i interesit, që lidhet me një periudhë prej më shumë se gjashtë muaj ose më pak se gjashtë muaj do të llogaritet mbi bazën e ditëve aktuale që numërohen midis datës së pagesave së tij, mbi bazën e një periudhe gjashtëmujore të 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve kalendarike.

9.4 Pagesa e interesit që lidhet me çdo disbursim duhet të bëhet në datat e përcaktuara të paraqitura në pasqyrën e pagesave të parashtruar në nenin 8.7 deri në datën e dorëzimit të njohjes së borxhit referuar nenit 10 më poshtë; për periudhën pasuese shlyerja e principalit dhe pagesat e interesit do të bëhen në datat e përcaktuara të treguara në pasqyrën e shlyerjeve bashkëngjitur njohjes së borxhit të lartpërmendur.

9.5 Banka shqiptare në emër të Huamarrësit merr përsipër të bëjë pa vonesë të gjitha pagesat dhe shyerjet që rezultojnë nga kjo Marrëveshje, si dhe gjithashtu nga njohja e borxhit, në datën e përcaktuar aktuale, për shumën korresponduese në euro, në favor të Artigiancassa ose personit/personave të autorizuar nga ajo. Shuma të tilla do të kreditohen pa zbritjet e ndonjë banke dhe/ose të normës të shkëmbimit dhe/ose taksave dhe pa lajmërim prej saj nga Artigiancassa ose personat e autorizuar prej saj.

Neni 10
Dorëzimi i njohjes së borxhit

10.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike prej datës së skadimit të disbursimit të fundit të Huasë së Butë të shprehur në nenin 5.1, Huamarrësi do t'i dorëzojë Artigiancassa-s njohjen e borxhit të nënshkruar siç duhet dhe të sigluar në çdo faqe në formën e aneksit C.

10.2 Pasqyra e shlyerjeve të shprehura në njohjen e borxhit do të kompletohet duke mbledhur të gjitha kështet e principalit dhe të interesit akoma të pamaturuara dhe kështet të cilat janë maturuar, por nuk janë paguar në datën e dorëzimit të njohjes së borxhit, të parashikuar në pasqyrën e shlyerjeve përkatëse për çdo disbursim, në përputhje me kushtet e nenit 8.7.

10.3 Artigiancassa do të depozitojë njohjen e borxhit për regjistrim dhe administrim të saj dhe herë pas here do të shënojë në njohjen e borxhit pagesat e principalit dhe të interesit së bashku me kështet e mundshme, të cilat janë maturuar, por nuk janë paguar. Sapo të gjitha pagesat e parashikuara në njohjen e borxhit do të bëhen, Artigiancassa do t'i kthejë njohjen e borxhit Huamarrësit të nënshkruar siç duhet dhe të vërtetuar.

Neni 11
Angazhimi i Huamarrësit

11.1 Angazhimi i Huamarrësit për të paguar shumat e detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje dhe njohjen e borxhit në lidhje me të, është i pavarur, i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

Neni 12
Pengesat dhe forcat madhore

12.1 Në rast të pengesave për zbatimin e programit për shkak të forcave madhore (si luftë përmbytje, zjarr, tërmet, konflikte pune dhe greve, veprime të ndonjë qeverie, vështirësi të papritura të transportit, punës apo rasteve të tjera) do të aplikohen kushtet e specifikuara nga Marrëveshja Qeveritare. Artigiancassa do të ndjekë udhëzimet e Autoritetit Kompetent Italian lidhur me aktivitetet e programit.

Neni 13
Pezullimi i disbursimeve

13.1 Gjatë periudhës së disbursimit të Huasë së Butë, Artigiancassa rezervon të drejtën për të pezulluar ndonjë Kërkesë Disbursimi sipas nenit 8, në rast të ndonjë mospërmbushje përkundrejt Artigiancassa-s sipas kësaj Marrëveshjeje ose kredive të tjera financiare të dhëna nga Republika e Italisë Qeverisë ose Bankës Qendrore ose Agjencive Shtetërore të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 6 të ligjit nr.38 të 9 shkurtit 1979 dhe të nenit 6 të ligjit nr.49 të 26 shkurtit 1987 të Republikës së Italisë, si dhe të amendimeve të tij kohë pas kohe. Artigiancassa do të informojë në kohë Huamarrësin dhe bankën shqiptare për pezullim të tillë.

13.2 Artigiancassa do të ekzekutojë çdo Kërkesë Disbursimi parashikuar sipas nenit 8, në rast se shumat korresponduese janë bërë disponibël nga Autoriteti Kompetent Italian. Artigiancassa nuk do të gjykohet përgjegjëse përballë Huamarrësit në rast se shuma për t'u disbursuar sipas Huasë së Butë nuk do të bëhet disponibël nga Autoriteti Kompetent Italian.

Neni 14
Interesvonesa

14.1 Nëse për ndonjë arsye, çfarëdoqoftë, Artigiancassa nuk merr shumat detyrim për principalin dhe/ose interesin në datën kur ato janë detyrim për t'u paguar, Huamarrësi do të jetë i detyruar t'i paguajë Artigiancassa mbi shumën e përmendur, interesvonesa që nga data e detyrimit deri në datën e kreditimit efektiv në favor të Artigiancassa ose të personit/ave të caktuar për këtë.

14.2 Ky interesvonesë, që rrjedh nga dështimi për të vepruar, do të përllogaritet duke zbatuar formulën e interesit të thjeshtë me një normë prej 0.1% (zero presje një për qind) për periudhën prej 35

(tridhjetë e pesë) ditëve kalendarike, menjëherë vijuese nga data origjinale e detyrimit, dhe më pas me një normë prek 2.6% (dy presje gjashtë për qind) deri në datën e kreditimit efektiv të Artigiancassa. Ky i dyti, do të përditësohet nga Autoritetet Kompetente Italiane; një përditësim i tillë do të ndodhë nga 1 janari 2007.

14.3 Rishikimi ka si qëllim sjelljen e interesvonesës në të njëjtën linjë me, dhe për asnjë arsye jo më të lartë se Norma Referencë e Interesit Tregtar (NRIT) e publikuar çdo muaj nga OECD.

Neni 15
Taksat

15.1 Çdo taksë prezente ose e ardhshme të cilat mund të jenë të detyruara në Shqipëri për çfarëdo arsyeje të lidhur me këtë Marrëveshje dhe me deklaratën njohjen e borxhit, do të jenë në ngarkim të Huamarrësit.

15.2 Ndonjë taksë detyruese në Itali lidhur me këtë Marrëveshje nuk do të jetë në ngarkim të Huamarrësit.

15.3 Artigiancassa deklaron që do t'i nënshtrohet statusit të taksave, parashikuar sipas nenit 19 të dekretit të Presidentit të Republikës nr.601 të 29 shtatorit 1973, të amenduar herë pas here.

Neni 16
Ligji qeverisës

16.1 Kjo Marrëveshje do të qeveriset dhe rregullohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 17
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

17.1 Palët veç kësaj do të përpiqen të zgjidhin miqësisht ndonjë mosmarrëveshje të lindur ose nga interpretimi dhe/ose performanca e kësaj Marrëveshjeje.

17.2 Nëse këto përpjekje nuk çojnë në ndonjë zgjidhje të mosmarrëveshjes brenda një periudhe kohore të arsyeshme, mosmarrëveshja do të zgjidhet në një nivel qeveritar.

17.3 Nëse edhe kjo përpjekje do të dështonte ose (nëse përpjekja është bërë) nuk do të jepte një rezultat të kënaqshëm, të gjitha mosmarrëveshjet e ngritura prej ose në lidhje me marrëveshjen do të zgjidhen përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë nga një gjyq arbitrazhi prej tre arbitrash:

-një arbitër i emëruar nga Huamarrësi;

- një arbitër i emëruar nga Artigiancassa;

- arbitri i tretë do të emërohet nga arbitrat e lartpërmendur ose në rast të mosmarrëveshjes në mes tyre nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

17.4 Nëse Huamarrësi ose Artigiancassa nuk emërojnë arbitrat e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditësh prej kërkesës së palës tjetër, ky arbitër do të emërohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

17.5 Vendimi i gjyqit të arbitrazhit, i cili do të vendosë në përputhje me ligjin e Republikës Italiane, do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm pa kushte për të dyja palët pa ndonjë mundësi apelimi.

17.6 Asnjë mosmarrëveshje ose debat që mund të ngrihet ndërmjet palëve për më tepër nuk do të pezullojë detyrimet e Huamarrësit për të paguar, në datën e përcaktuar të rënë dakord, të gjitha shumat e përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti të gjitha shumat që rezultojnë prej pasqyrës së shlyerjeve të shprehura në nenin 8 më sipër dhe prej njohjes së borxhit që lidhet me të.

Neni 18
Njoftime

18.1 Njoftimet për t'u dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje do të adresohen si më poshtë:

- Ministria e Financave: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tirana-Albania, Tel +355 (4) 250264; - Fax 355 (4)228494;

- Raiffeisen Bank, in Albania: Rruga e Kavajës, Tirana, Tel +355 (4)22609, Fax +355(4)229304

- Artigiancassa S.P.A Via Crescenzo del Monte”%-Romë-Italy Nucleo Operativo Lex N:49/1987, N: telephone 0039-06-5845529-561-414 Telefax N:0039-06-5845466.

Neni 19

Tekstet origjinale të Marrëveshjes financiare

19.1 Kjo Marrëveshje nënshkruhet në tre kopje në anglisht